

këtë e lozin në për gjithërinjtë! “Kështu i ka dhan ilame Henglizi Allamanjës, por Allemanja nuk u tremp hiç se një me një është më i fort’ i Evropës.”, thotë eksperti. Tjatri ja pret me këtë mënyrë: “Asht e vërtetë që Allamanja është më i fortë i gjithë Evropës, por Henglizi është i rrethuem me det, e s’ ka ka i hyn Allamanja e luftën më tepër e bajn n’ hava!” Të vegjëlit dëgjojnë me gojë hapur profitët modern, dhe nuk çfaqin nonjë mendim se nuk u bie radha.

Bisedimet nuk vërtiten vetëm reth politikës së përbotëshme po edhe reth ngjarjeve plot trimëri të Mirditës. Pleqtë natyrisht mburen për kohën e kaluar që ka qënë madhësh'ore dhe u tregojnë të rinjve si kishin qënë ata burra të mocmë që kishin ruajtur fë e zakone me gjithë “bidatet” e vëndit, dyke lëfuar me Karadak e me të tjerë armiq, të cilët i thyenin gjithmon, si filani ka qënë trim me fletë dhe si ka lëfuar burrërisht kundra një fuqie zaptiesh të madhe, ose si filani burrë nderoj vedin e nderoj fisin dyke marë gjakun e vllaut të vet, etj., etj. Burrit i ka dalë edhe kënga dhe të rinjtë, dyke dëgjuar hollësisht nga goj’ e pleqve, kanë dashur të fitojnë nam, shumë herë dyke vënë në rezik jetën e tyre.

Dimri ka bukurin’ e vet sepse atëherë butrat e dheut me gjithë fëmijë rinë afër zjarrit edhe